



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401695/5

Tiranë, ___.___.2014

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për korrigjimin e emrit të shtetasës L. B.*

Drejtuar: **ZYRËS SË GJENDJES CIVILE**
Pranë Njesisë Bashkiake nr.4

TIRANË

Për dijeni: **MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME**
Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

TIRANË

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasja **L. B.**, e cila ankohet ndaj Zyrës së Gjendjes Civile, pranë Njesisë Bashkiake nr.4, Tiranë, për ndryshim të paautorizuar të emrit.

Konkretisht, ankuesja pretendon se është trajtuar me pension pleqërie dhe ka tërhequr rregullisht pensionin, deri në shtator 2011. Pas kësaj periudhe, deri në maj 2014, ankuesja, për arsye shëndetësore, nuk e ka tërhequr pensionin, por kur është paraqitur pranë zyrës së pensioneve, punonjësja e arkës, i ka komunikuar se ajo rezulton me një identitet tjetër (ka ndërruar emrin nga "L." në "D."). Për këtë ndryshim të paautorizuar të emrit, ankuesja, është drejtuar në Zyrën e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. 4, Tiranë, për të kërkuar informacion, por nuk ka marrë asnjë shpjegim.

Sa sipër, ankuesi ka kërkuar edhe ndihmën e Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim ndërmjetësimin pranë jush për trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj ankese.

Në përgjigje të kërkesën tonë, me shkresën nr. 1413/1 Prot., datë 29.10.2014, Zyra e Gjendjes Civile pranë Njesisë Bashkiake Nr. 4, Tiranë, bën me dije se: "**... Për çdo informacion, duhet të drejtoheni në Fletoren Zyrtare nr. 62, datë 05.05.2014, duke respektuar pikat e Udhëzimit nr. 95, datë 07.04.2014, "Për përcaktimin e Institucioneve dhe Organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin"**.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke e konsideruar ankesën e shtetasës L. B., të drejtë dhe të bazuar, parashtron sa më poshtë:

Sipas Udhëzimit të mësipërm, "**Për përcaktimin e Institucioneve dhe Organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin**", në pikën 1, citohet:

"... 1. *Institucionet/organet që mund të marrin të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, nga regjistrat themeltarë dhe nga aktet e gjendjes civile, janë ato, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë...*"

Në nenin 19, shkronja "b" të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, thuhet: "Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Pra, sipas këtij neni, Zyra e Gjendjes Civile, pranë Njesisë Bashkiake nr. 4, Tiranë, e ka detyrim ligjor t'i përgjigjet me informacion kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Mosveprimi nga ana juaj, për zbatimin e dispozitave ligjore të mësipërme, nxjerr si konkluzion një zvarritje dhe mosveprim të dukshëm të zyrës së gjendjes civile, fakt që ka sjellë për pasojë shkeljen e të drejtave të ligjshme të kësaj shtetase, duke u bërë edhe pengesë për mos kryerjen e veprimeve të mëtejshme, në rastin konkret për tërheqjen e pensionit.

Në këtë kuadër, lidhur me mirëfunksionimin e organeve të administratës shtetërore, Avokati i Popullit nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, qëllimi i mirë për përmirësimin e punës, si dhe për një zgjidhje sa më të drejtë dhe ligjore të kësaj ankese e çmon me vend të bëjë këtë rekomandim, duke shpresuar se kështu do të ndihmojmë bashkërisht për vënien në vend të së drejtës së shkelur ndaj shtetases L. B.

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcakton se "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime" dhe në mbështetje të nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 21/b, të Ligjit Nr. 8454, datë 4.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", në të cilët përkatësisht thuhet se: "Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme për korrigjimin e emrit të shtetases L. B., nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Njesisë Bashkiake Nr. 4, Tiranë.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, lutemi na ktheni përgjigje të argumentuar brenda afatit 30 ditor lidhur me masat ligjore dhe qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi,

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Etilda GJONAJ (SALIU)